



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Duke u bazuar në nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Aktgjykimin Nr. KO203/19 e Gjykatës Kushtetuese, Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenin 3, paragrafi 2, nënparagrafi 2.11, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, Komisioni i Pavarur i Mediave miraton:

**RREGULLORE**

**Nr. 04/2021**

**PËR ZGJIDHJEN E ANKESAVE NË KOMISIONIN E PAVARUR TË MEDIAVE**

**KAPITULLI I**

**Dispozitat e përgjithshme**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë procedurat për zgjidhjen e ankesave nga marrëdhëniet e punës në Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM), kompetencat dhe kriteret për emërimin e anëtarëve të Komisionit për zgjidhjen e ankesave (tutje: Komisioni), procedurën e dorëzimit të ankesave, procedurën për shqyrtimin e ankesave dhe nxjerrjen e vendimit nga Komisioni.

**Neni 2**

**Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje janë të zbatueshme për Komisionin dhe palët ankuuese, qofshin ata punonjës në KPM apo persona që aplikojnë për rekrutim në KPM.

**Neni 3**

**Përkufizimet**

Terminologjia e përdorur në këtë Rregullore e ka kuptimin siç është definuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

**KAPITULLI II**

**Neni 4**

**E drejta e ankesës**

1. Nëpunësit civilë në Zyrën Ekzekutive dhe pjesëmarrësit tjerë në procedurat e punësimit për vendet e punës për nëpunës civilë kanë të drejtë ankesë kundër vendimit administrativ apo shkeljeve të pretenduara ose nxjerrjes së rregullave/procedurave të përgjithshme administrative, që ndikojnë dhe që kanë të bëjnë me marrëdhënien e tyre të punës apo për themelimin e marrëdhënies së punës.
2. Personat për të cilët zbatohet kjo Rregullore kanë të drejtë mbrojtjeje fillimisht përmes organeve dhe procedurave të brendshme administrative në rast të shkeljes së të drejtave të

tyre, që rezultojnë nga veprimet apo mosveprimet administrative të Zyrës Ekzekutive, përveç rasteve të përcaktuara ndryshe me këtë Rregullore apo me dispozita tjera ligjore të veçanta.

3. Ankesa mund të parashtrohet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

#### **Neni 5**

#### **Komisioni për zgjidhjen e ankesave**

1. Komisioni themelohet në kuadër të Zyrës Ekzekutive, si organ për pranimin, shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave.
2. Vendimet e Komisionit janë të detyrueshme për Zyrën Ekzekutive dhe për të gjitha palët përkatëse.
3. Kundër vendimit të Komisionit pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

#### **Neni 6**

#### **Procedura e emërimit të Komisionit**

1. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit emërohen nga radhët e stafit të Zyrës Ekzekutive, me përgatitje superiore shkollore. Anëtarët emërohen nga Kryeshefi Ekzekutiv.
2. Anëtarët e Komisionit emërohen për periudhën dy (2) vjeçare, me mundësi vazhdimi vetëm edhe për një mandat. Përbërja e Komisionit duhet të pasqyrojnë diversitetin e shoqërisë kosovare, duke përfshirë sidomos diversitetin gjinor.
3. Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit nuk mund të shërbejnë në të njëjtën kohë edhe si anëtarë të komisionit disiplinor në Zyrën Ekzekutive.
4. Në rast kur Kryesuesi apo anëtarët e Komisionit kanë konflikt interesi apo kur konflikti i interesit paraqitet ndërkohë, ata zëvendësohen nga Kryeshefi Ekzekutiv.

#### **Neni 7**

#### **Përbërja e Komisionit të ankesave**

1. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje:
  - 1.1. Nëpunës civil, i nivelit drejtues – Kryesues i Komisionit; dhe
  - 1.2. Nëpunës civilë të nivelit profesional – dy (2) anëtarë.

## **Neni 8**

### **Përfundimi i mandatit të anëtarëve të Komisionit**

Mandati i anëtarëve të Komisionit përfundon me skadimin e periudhës dy (2) vjeçare të emërimit, ose në rastet kur anëtarët e Komisionit zëvendësohen për shkak të rrethanave të tjera para përfundimit të mandatit.

## **Neni 9**

### **Shërbimet administrative të Komisionit**

1. Njësia e Burimeve Njerëzore (NJB NJ) shërben si sekretariat për Komisionin dhe ka këto përgjegjësi:
  - 1.1. Pas pranimit të ankesës informon anëtarët e Komisionit për paraqitjen e saj dhe të njëjtën e përcjellë të shoqëruar me provat e dorëzuara nga pala ankuese tek Komisioni, brenda dy (2) ditëve të punës;
  - 1.2. Ofron udhëzime procedurale për anëtarët e Komisionit;
  - 1.3. Bënë përgatitjen administrative për mbajtjen e seancës së Komisionit;
  - 1.4. Njofton anëtarët e Komisionit dhe palët për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës;
  - 1.5. Mban procesverbalin e seancës;
  - 1.6. Njofton palët lidhur me vendimin e Komisionit;
  - 1.7. Ruan vendimin e Komisionit në dosjet personale të palëve të përfshira në kontest.

## **Neni 10**

### **Mbajtja e seancës**

1. Komisioni fillimisht duhet të mundohet që këtë çështje ta zgjidhë në mes të palës ankuese dhe palës ndaj të cilës është bërë ankesë.
2. Në pamundësi të arritjes së një kompromisi në mes të palëve, Komisioni fillon shqyrtimin e ankesës.
3. Komisioni i shqyrton dëshmitë e siguruara dhe në bazë të tyre vendosë nëse pranohet ankesa apo jo.
4. Pas shqyrtimit të ankesës Komisioni merr vendim me shumicë të votave.
5. Komisioni duhet të merr vendim brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të ankesës.
6. Për vendimin e Komisionit si dhe procedurat tjera që duhet vepruar, NJBNJ e njofton palën ankuese brenda afatit prej pesë (5) ditësh nga dita e marrjes së vendimit.
7. Njoftimi bëhet me shkrim në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me legjislacionin përkatës.

**Neni 11**  
**Zbatimi i vendimeve të Komisionit**

Vendimet e Komisionit janë të detyrueshme për Zyrën Ekzekutive dhe për të gjitha palët përkatëse.

**Neni 12**  
**E drejta e ankesës kundër vendimit të Komisionit**

Kundër vendimit të Komisionit, palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh.

**KAPITULLI III**  
**Dispozitat përfundimtare**


**Neni 13**  
**Publikimi**

Rregullorja duhet të publikohet në ueb faqen e KPM-së, me qëllim që të gjithë punonjësit të jenë të informuar për hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje.

**Neni 14**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas miratimit nga Komisioni i Pavarur i Mediave.

Xhevat Latifi

  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave

